

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068:

KOPSHTI PARASHKOLLOR NË LAGJEN ARBËRIA SHPALL

KONKURS

PËR KËTO VENDE TË LIRA TË PUNËS:

Nive li	Institucioni	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Kodi i pozitës	Vend i lirë/ Zëvendësim
IP	Kopshti parashkollor	Arbëria III	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	01	Vendi i lirë
IP	Kopshti parashkollor	Arbëria III	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	02	Vendi i lirë
IP	Kopshti parashkollor	Arbëria III	Një edukator/e për moshën 3-6 vjeç	03	Vendi i lirë
IP	Kopshti parashkollor	Arbëria III	Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	04	Vendi i lirë
IP	Kopshti parashkollor	Arbëria III	Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	05	Vendi i lirë
IP	Kopshti parashkollor	Arbëria III	Një motër edukatore për moshën 0-3 vjeç	06	Vendi i lirë

Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë, sporteli nr. 5).
- Rezymeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), **certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara të noteri.** Diploma ose certifikata duhet të përcaktoj qartë notën mesatare.

Dëshmi shtesë për fazës paraseleksionuese :

- Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT, gjegjësisht **vetëm ato që konsiderohen relevante për nivelin e arsimit përkatës nga ana e institucionit.**
- Dëshmi të përvojës së punës vetëm në institucione arsimore (**vetëm kontrata ose vërtetimi i nga ana e punëdhënësit që përcakton qartë kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës do të merren parasysh**).

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DKA në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës (UA Nr. 09/2014). **Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim.**

Sqarime shtesë:

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Me rastin e marrjes së aplikacionit, kandidatët mund të marrin edhe dokumentin ku përshkruhet procedura e përzgjedhjes dhe dokumentin ku përshkruhen kriteret e paraseleksionimit.

Për intervistë do të ftohet 3-5 kandidatët që i plotësojnë më së miri kushtet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Përzgjedhja për intervistë do të bëhet bazuar në kualifikimet formale adekuate, përvojën e punës relevante në arsim, trajnimet e përfunduara relevante të akredituara nga MASHT dhe notën mesatare gjatë studimeve.

Shënim: master i papërfunduar duhet të sillen certifikata e notave (origjinale).

Nëse i njëjti person aplikon në më shumë se një pozitë/institucion, atëherë për secilën pozitë/institucion duhet të dorëzojë aplikacionin e veçantë të kompletuar. Por, nëse kandidati i plotëson kushtet për t'u ftuar në intervistë, mund të ftohet në intervistë vetëm për një pozitë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur prej datës **7 prill - 22 prill 2016**. Aplikacionet mund të dorëzohen çdo ditë pune nga ora **09:00 - 15:00**. Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë (sporteli nr.5), në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.

Aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.